



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:139613

Datë: 23.05.2024

Numri i dokumentit: 05726121

Ac.nr.4132/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Ademi Kryetar i kolegjit Hidajete Gashi Alaj dhe Adnan Konushevci, anëtar të kolegjit me bashkëpunëtorin profesional Shpëtim Azemi në çështjen juridike – kontestimore të paditësve M.O., M.O.1., A.O., E.O. dhe S.O. që të gjithë nga fsh ... - Komuna Prizren, të cilët i përfaqëson i autorizuari i tyre av. B.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike -KEDS Sh.A, distrikti në Prizren, të cilën e përfaqësojnë A.K. dhe B.P., punëtorë pranë të njëjtës, dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural–Agjencia Pyjore e Kosovës (APK) rr. “Zenel Salihu” 1/A, në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson i autorizuari i saj L.M., me objekt konteksti kompensim të dëmit, duke vendosur në lidhje me ankesat e të të paditurave dhe me ankesën e paditësve të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni, C.nr.961/19, të datës 22.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.05.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pathemelta: ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës KEDS Sh.A, ankesa e përfaqësuesit të të paditurës Agjencia Pyjore e Kosovës si dhe ankesa e përfaqësuesit të paditësve av. B.M., ndërsa aktgjykimi Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil C.nr.961/19, i datës 22.02.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.961/19, i datës 22.02.2021, ka vendosur si në vijim;

“I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësve M.O., M.O.1., A.O., E.O. dhe S.O. që të gjithë nga fshati ..., komuna e Prizrenit, dhe **DETYROHEN** të paditurit dhe atë: KEDS – Distrikti Prizren të paguaj shpërblimin e dëmit në **80 %** të shumave të cekura si më poshtë, dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia Pyjore e Kosovës në Prishtinë

20% të shumave të cekura si më poshtë, në emër të dëmit jo material dhe material, duke iu kompensuar paditësve shumat si në vijim:

A). Dëmi jo material

a). Paditëses **M.O.:**

- në emër të dhimbjeve shpirtërore për humbjen (vdekjen) e bashkëshortit, shumën prej 7,500.00 euro;

b). Paditësve **M.O.1., A.O. dhe E.O.:**

- në emër të dhimbjeve shpirtërore për humbjen (vdekjen) e babait, secilit shumën prej nga 7,500.00 euro;

c). Paditëses **S.O.:**

- në emër të dhimbjeve shpirtërore për humbjen (vdekjen) e të birit, shumën prej 7,500.00 euro

B). Dëmi material

Në emër të shpenzimeve të ceremonisë së varrimit dhe ngritjes së përmendores shumën prej 2500 euro.

Apo shumën e përgjithshme në emër të dëmit material dhe jo material në shumën prej 40.000 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi (22.02.2021), e deri tek pagesa definitive të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

II. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve mbi shumat e aprovuara sikurse në pikën I të dispozitivin të këtij aktgjykimi nën **pika A dhe B**, si dhe pjesa e kërkesëpadisë e cila ka të bëjë për mbajtjen-rentën mujore për bashkëshorten e të ndjerit në shumën prej 500 euro, në muaj **refuzohet si e pa bazuar.**

III. Obligohen të paditura të cekura si më lartë konform përqindjes së cekur në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, paditësve t'ia paguajnë shpenzimet procedurale dhe atë në lartësi prej **4,450.00 euro**, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm “

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i paditësve për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të caktoj rentën për paditësen e parë, ta ndryshoj aktgjykimin dhe të aprovoj kërkesën siç është kërkuar me anë të padisë.

Ankesë në afat ligjor kundër aktgjykimin të shkallës së parë po ashtu ka paraqitur përfaqësuesi i të paditurës KEDS, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e shkallë së dytë ta anuloj aktgjykimin e atakuar, ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësve në tërësi si të pabazuar sa i përket detyrimit të të paditurës së parë, apo ta kthej çështjen në rigjykim dhe rivendosje.

Po ashtu ankesë brenda afatit ligjor kundër aktgjykimin të shkallës së parë ka paraqitur, përfaqësuesi i të paditurës Agjencia Pyjore e Kosovës, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktgjykimi i ankimuar të priset dhe çështja t'i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim

dhe rivendosje apo që i njëjti të ndryshohet dhe ankesa e të paditurës së dytë Agjencia Pyjore e Kosovës të miratohet në tërësi si e bazuar.

Përgjigje ndaj ankesave të të paditurave ka parashtruar përfaqësuesi i paditësve, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, ankesat e të paditurave t'i refuzoj si të pa bazuara, ndërsa të aprovoj ankesën e paditësve si të bazuar.

Gjykata e Apelit si Gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e paditësve është e pa themeltë

- Ankesat e të paditurave janë të pa themelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, me datë 29.06.2019 në Gjykatën e shkallës së parë kanë paraqitur padi, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimeve dhe kthimin në punë me arsye si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.961/19, i datës 22.02.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas analizimit të dokumenteve që gjenden në shkresat lëndës, nga provat e administruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore për palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se I.O. (tani i ndjerë), ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura e dytë dhe ka kryer punës e zjarrfikësit, ndërsa me datën 29.10.2018, në vendin e quajtur "Kolonesh" në afërsi të fshatit Struzhë, në komunën e Prizrenit, kishte humbur jetë, fakt ky cili ishte konstatuar nga mjeku i emergjencës, në vendin e ngjarjes. Po ashtu nuk ishte kontestuese se paditësit kanë legjitimitet aktiv në këtë çështje juridike pasi që të njëjtit janë anëtarët e familjes së ngushtë të të ndjerit, fakt ky që është vërtetuar nga certifikatat e lindjes dhe ajo e bashkësisë familjare dhe fakt të cilin të paditurat nuk e kanë kundërshtuar.

Po ashtu mes palëve nuk ishte kontestues fakti se i ndjeri I.O. ka vdekur si pasojë e kontaktit me kabllon elektrik apo siç është konstatuar përmes raportit të autopsisë me nr. MA18-319 të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë – Instituti i mjekësisë ligjore i datës 11.02.2019, ku është vërtetuar se vdekja e të ndjerit I.O., ka qenë e dhunshme e cila ka ardhur si pasojë e ndërprerjes (arrestit) kardio-respirator, si rrjedhojë e përcimit (kalimit) të rrymës elektrike të voltazhit të lartë nëpër trupin e tij. Në këtë autopsi janë përshkruar të gjitha lëndimet që i janë shkaktuar të ndjerit përkatësisht shenjat në trupin e tij. Në lidhje me këtë, nga foto albumi i njësisë së Forenzikës të fotografuar në ditën dhe vendin kritik, është vërtetuar se në afërsi të trupit të pajetë të ndjerit, ka qenë pjesa e telit të rrymës e tensionit të lartë, në këtë rast i këputur dhe i shtrirë në tokë, ndërsa kufoma (i ndjeri) tërësisht e djegur nga plagët që i janë shkaktuar nga rryma e tensionit të lartë. Në këtë drejtim është edhe raporti i QKMF-së, në Prizren, i datës 29.10.2018. Gjykata ka vlerësuar se këto fakte nuk janë kontestuese pasi që palët në pretendimet të tyre nuk i kanë kundërshtuar dhe se nuk kanë pasur vërejtje në provat të cekura si më lartë, andaj të njëjtëve Gjykata ia ka falur besimin e plotë. Për palët ndërgjyqëse ka mbetur kontestuese se kush është përgjegjës në aspektin civil për vdekjen e të ndjeri I.O. apo se kush është përgjegjës për kompensimin e dëmit këtu paditësve për shkak të dhimbjeve shpirtërore të humbjes së jetës së anëtarit të familjes së tyre dhe dëmit materiale për shkak të ceremonisë së varrimit dhe ngritjes së përmendores.

Tutje ka theksuar se, në bazë të ekspertizës A.K., ka shpjeguar mënyrën e punimit të ekspertizës duke shtuar se punëtori ka pësuar lëndime vdekjeprurëse si pasojë e goditjes nga energjia elektrike, në mënyrë ekzakte janë paraqitur lëshimet e KEDS-it, sepse sistemi elektro energjetik respektivisht pajisjet e të cilave ka pësuar apo ka humbur jetë punëtori ishin pikërisht të atyre. Në bazë të lëshimeve është ndarë edhe përgjegjësia sikurse në përfundimin e dhënë në ekspertizë. I ndjeri I.O., ka qenë me profesion dhe i angazhuar në veprim atë ditë si zjarrfikës, prandaj pajisjet personale të zjarrfikësit nuk janë të destinuar për mbrojtje elektrike por për mbrojtjen nga zjarri. Nga certifikatat e lindjes për paditësit M.O., M.O.1., A.O., E.O. dhe S.O., të gjitha të lëshuara nga organet kompetente të Komunës së Prizrenit me datën 13.03.2019, dhe deklarata për bashkësinë familjare me nr. F11015658 të lëshuar nga komuna e Prizrenit të datës 04.12.2020, Gjykata e ka vërtetuar se paditësit janë trashëgimtar të të ndjerit I.O. dhe atë bashkëshortja dhe fëmijët e të ndjerit, ndërsa paditësja S.O. është e ëma e të ndjerit. Nga marrëveshja për angazhimin në masën aktive të tregut të punës, nënshkruar nga përgjegjësit e të paditurës së dytë dhe të ndjerin I.O. e datës 30.03.2018, Gjykata ka vërtetuar se i ndjeri I.O. ka qenë i punësuar si zjarrfikës në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltariës dhe Zhvillimit Rural–Agjencia Pyjore e Kosovës, nga periudha 02.04.2018, e deri më datë 31.10.2018. Ndër të tjera sipas nenit 3.2 të kësaj marrëveshje, punëdhënësi ka pas për detyrë dhe përgjegjësi të ofrojë siguri dhe shëndet në punë sipas ligjeve në fuqi dhe kushteve të përshtatshme të punës së pjesëmarrësve. Duke marrë për bazë të cekurat më lartë Gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar, andaj ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke pasur parasysh faktin se për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i tij, për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të, apo se organizata punuese – punëdhënësi është përgjegjës ndaj punëmarrësit dhe dëmeve të pësuar nga ana e tij në lidhje me punën dhe detyrave të dala nga puna, rrjedhë konstatimi se për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm përgjegjës do të jetë ndonjëri nga këta persona, varësisht nga ajo se çfarë të drejte kanë mbi atë send, veprimtari apo punëdhënësi ndaj punëtorit të tij. Në rastin konkret të paditurat në proporcion të caktuar nga Gjykata kanë obligim që paditësve ti kompensojnë dëmi e shkaktuar për shkak të dhimbjeve shpirtërore pas vdekjes së familjarit të tyre (bashkëshortit, babait përkatësisht birit të paditësve). Dhimbja shpirtërore për humbjen e anëtarit të familjes është fakt notor dhe se Gjykata nuk e ka parë të nevojshme që dhimbjen shpirtërore tek paditësit të vërtetoj me prova të veçanta, pasi që humbja e bashkëshortit, babait përkatësisht birit ka shkaktuar dhimbje tek paditësit dhe të njëjtit duhet të kompensohen apo se të njëjtëve u takon e drejta e kompensimit të dëmit jo material, e që mund të jetë një formë e satisfaksionit moral për humbjen e familjarit të tyre.

Për kamatën e aplikuar Gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 382 të LMD-së si dhe duke u mbështetur në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 01.12.2020, që përcakton llogaritjen e kamatës ligjore “nga data e arritjes për secilën kërkesë veç e veç e deri në pagesën definitive, pavarësisht nga data kur kërkohet mbrojta gjyqësore, bëhet vlerësimi me ekspertize apo nxirret vendimi i Gjykatës së shkallës së parë”.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerra konform nenit 449 dhe 452.2 të LPK-së si dhe sipas TOAK.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë ndërsa edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurave se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga nenin 183.1 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadsisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata ankimore po ashtu nuk i mbështet pretendimet e paditësve dhe të paditurave lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për faktin se Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të të gjitha fakteve dhe provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadsinë e paditësve. Në këtë çështje juridike nuk ka qenë kontestues fakti se i ndjeri paraardhësi i paditësve ka gjetur vdekjen nga kontakti i tij me telin përques dhe në atë moment ka qenë i angazhuar në punë sipas kërkesës së punëdhënësit. Nuk është kontestues faktik se teli apo përquesi ka qenë në menaxhim të të paditurës KEDS- Distrikti Prizren. Nga autopsia është vërtetuar se shkak i vdekjes ka qenë si rezultat i kontaktit direkt të paraardhësit të paditësve me telin në fjalë. Nga ekspertiza e sigurisë në punë është konstatuar se përgjegjësi primare bartë e paditura e parë KEDS për shkak të mosmirëmbajtjes së rrejtë, ndërsa përgjegjësi sekondare e paditura e dytë Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia Pyjore e Kosovës si punëdhënëse për shkak të mosndërmarrjes së masave adekuate nga lëmia e mbrojtjes dhe sigurisë në punë pasi ka qenë dashur që të ketë hartën e intervenimit në shuarjen e zjarrit, ashtu që do të duhej të ishte në dijeni se aty kalon largpërquesi. Ekspertët poashtu kanë konstatuar se pavarësisht mënyrës se si ka ardhur deri të këputja e largpërquesit, sistemi i sigurisë ka qenë dashtë përmes sistemit të mbrojtjes t'a qes sistemin prej funksionit. Në raport me lartësinë e kompensimit të dëmit për dhimbje shpirtërore lartësia e dëmit është në përputhje me praktikën gjyqësore të kohës së nxjerrjes së aktgjykimit, me qëllimin e ligjit pasi në secilin rast e sidomos tek lëndimet apo edhe tek dhimbjet shpirtërore për humbjen e anëtarit të familjes, kompensimi është vetëm satisfakcion moral, dhe se nuk ka qëllim tjetër sepse nuk ka lartësi të kompensimit që mund të llogaritet e barazvlefshme me jetën e njeriut, pasi këto mjete nuk ia zëvendësojnë paditësve burrin respektivisht prindin.

Pra, në çdo rast për dëmin jo material dhe material, Gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi tu shkoj përshtati qëllimeve që synohen me kompensimin e dëmit e që është satisfakcion për të dëmtuarit. Mbi këtë bazë Gjykata e Apelit duke e pasur parasysh natyrën e dhimbjeve shpirtërore dhe mënyrën se si është manifestuar dhimbja te paditësit si dhe rrethanat tjera, si moshën e të ndjerit dhe praktikën e mirë gjyqësore, e të cilat rrethana janë në pajtim të plotë me nenin 183 të LMD-së.

Baza juridike e kërkesëpadsisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësve, gjënë mbështetje në nenin 136, 137, 154, 177, 183 dhe 184 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 10 Maj 2012, i cili ka hyrë në fuqi nga data 20 Dhjetor 2012.

Me nenin 136.2 të LMD-së përcaktohet se: *“Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji.”*

Me nenin 137 të LMD-së përcaktohet se: *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material).”*

Me nenin 154 të LMD-së përcaktohet se: *“Dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit.”*

Me nenin 177.1 të LMD-së përcaktohet se: *“1. Kush shkakton vdekjen e ndokujt ka për detyrë që t'i shpërblejë shpenzimet e zakonshme të varrimit të tij.”*

Me nenin 183 par.1 dhe 2 të LMD-së përcaktohet se: *“1. Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, Gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. 2. Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, Gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.”*

Me nenin 184.1 të LMD-së përcaktohet se: *“1. Në rast vdekjeje të ndonjë personi, Gjykata mund t'ua caktojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijët dhe prindërit) shpërblim të drejtë në të holla për dhembjen e tyre shpirtërore.”*

Nga interpretimi i dispozitave të cituara më lartë pa mëdyshje vërtetohet baza juridike e kërkesëpadisë së paditësve për kompensimin e dëmit në emër të dhimbjeve shpirtërore në raport me të paditurat sepse paditësit kanë humbur anëtarin e familjes, bashkëshortin dhe prindin, ku vdekja e të njëjtit ka ardhur si rezultat i lëshimeve të të paditurave. E paditura e parë ka pasur obligim ligjor që të provojë plotësimin e kushteve për t'u liruar nga përgjegjësia si zotëruese e veprimtarisë së rrezikshme, mirëpo nuk e provoi një gjë të tillë, ndërsa nga ekspertizat e ekspertëve të lëmisë së sigurisë në punë është konstatuar se e paditura e parë është përgjegjëse për mirëmbajtjen e rrjetit, e po ashtu përgjegjëse për mosfunksionim të sistemit mbrojtjes në rast të këputjes së telit dhe kontaktin me tokën, e po ashtu edhe për shkak të mosmirëmbajtjes të rrjetit në zonë malore pasi bëhet fjalë për largpërçues. Përgjegjësia e të paditurës së dytë i atribuohet faktit se e njëjta si punëdhënëse nuk ka ndërmarrë masat e nevojshme mbrojtëse si dhe pajisjeve mbrojtëse për shkak të njohurisë së puna në fjalë është me rrezik.

Mbi bazën e ndarjes së përgjegjëse në mes të dy të paditurave drejtë shtë ndarë përgjegjësia 80 % me 20 %, sepse lëshimet e të paditurës së parë janë dukshëm më të mëdha dhe përgjegjësia e të njëjtës dukshëm më e madhe sesa lëshimet e të paditurës së dytë, mirëpo ndarja e tillë nënkupton zbatimin adekuat të parimit të ndarjes së drejtë të përgjegjësisë.

Gjykata e Apelit vlerëson se drejtë është vendosur kur është aprovuar kërkesëpadia e paditësve në raport me shpenzimet e varrimit dhe ngritjen e përmendores, pasi që një kompensim të tillë edhe parasheh edhe Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, neni 177 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *“1. Kush shkakton vdekjen e ndokujt ka për detyrë që t'i shpërblejë shpenzimet e zakonshme të varrimit të tij.”* Pra, në rastin konkret me kontaktin e të ndjerit me përçuesin e këputur ka ardhur edhe deri te vdekja e të ndjerit I.O., e që me këtë rast familjarët kanë pasur shpenzime sa i përket varrimit e po ashtu edhe ngritjes së përmendores e kjo duke pasur parasysh edhe zakonet e vendit.

Vendimi për kumatën për kategorinë e dëmit jo material është marrë konform nenit 382 të LMD-së në lartësi prej 8% e që duhet të rrjedh nga data e marrjes së aktgjykimit të Gjykatës së shkallës së parë si moment i njoftimit të paditurës lidhur me lartësinë e këtij dëmi.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4132/2021, me datë 23.05.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari

Faton Ademi, d.v